

## Abstrakti

- Ky punim ka për qëllim të shqyrtojë rolin kushtetues të Presidentit të Republikës për faljen e personit të dënuar, duke u fokusuar në aspektet krahasuese të praktikave të ndryshme juridike.
- Nëpërmjet një analize të thelluar të kompetencave dhe kufizimeve të Presidentit, punimi trajton rëndësinë e këtij institucioni në sistemin e drejtësisë penale, duke e lidhur me parimet e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut. Pjesa krahasuese e punimit shkon përtej kufijve të ligjit të brendshëm të Kosovës, duke shqyrtuar praktikën dhe procedurat e ngjashme në shtetet e tjera, si dhe pasojat që mund të lindin nga vendimmarrja për faljen e personave të dënuar.
- Në këtë kuadër, punimi analizën e rolin të Presidentit si një mekanizëm për lehtësimin e dënimeve dhe mundësinë e ndihmës për rehabilitimin e individëve të dënuar, duke u bazuar në ndihmën e mundshme për integrimin e tyre në shoqëri. Gjithashtu, shqyrton debatin rreth abuzimeve të mundshme me këtë të drejtë, pasojat politike dhe morale të vendimeve për falje, dhe ekuilibrin mes forcës juridike dhe asaj humane të këtij institucioni.
- Ky punim synon të ofrojë një pasqyrë të qartë mbi praktikën e faljes presidenciale, duke kontribuar në diskutimet ligjore dhe shoqërore rreth kufizimeve dhe mundësive që kjo fuqi kushtetuese ka në kontekstin aktual të Republikës së Kosovës.

***Fjalët kyçe:*** Falja presidenciale, Presidenti i Republikës së Kosovës, sistemi i drejtësisë penale, kompetencat kushtetuese, kufizimet ligjore, riintegrimi shoqëror, praktikën krahasuese ndërkombëtare.